



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 25.2.2025

Nr: 165

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE LËVIZJA “ATDHEU”, ME
KRYETAR Z. KRESHNIK OSMANI, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR
PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025**

Sot, më datë 25.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën nr. 1183 prot., datë 21.2.2025, me:

KËRKUES: Partia politike Lëvizja “Atdheu”, me kryetar Z. Kreshnik Osmani.

OBJEKTI: Regjistrimi i partisë politike Lëvizja “Atdheu ” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025

BAZA LIGJORE: Neni 64, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Partia Lëvizja “Atdheu” nëpërmjet Kryetarit, Z. Kreshnik Osmani, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend, që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

Data: 25.2.2025 Nr: 165
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike Lëvizja “Atdheu”, me Kryetar Z. Kreshnik Osmani, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 12.2.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se partia Lëvizja “Atdheu”, me initiale “LA”, me Kryetar Z. Kreshnik Osmani, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është: Lëvizja “Atdheu“ me shkronja nistore “LA”, me adresë: Pll. pranë "Luis Medical Center", Kompleksi Ferra, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Kreshnik Osmani, me adresë: Lgj. 6, Rruga "Dëshmorët", Pll. 346, Ap. 7, Durrës;
- c) Financieri i partisë është Z. Alban Vidhi , me adresë: Kompleksi "Fiori Di Bosko", Pll. 2, Shk. 2, Ap.18, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në, është Z. Edmond Dano, me adresë: Rruga "Sali Nivica", nr.1, H. 15, Ap. 64, Yzberisht, Kashar, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia Lëvizja “Atdheu”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga Partia Lëvizja “Atdheu”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 11 Maj 2025”.

V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike Lëvizja “Atdheu ”, me kryetar Z. Kreshnik Osmani, me shkronjat nistore “LA”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI